



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
DIBER

Nr _____ prot.

Datë ____/____/2024

DETYRË PROJEKTIMI
PËR HARTIMIN E PROJEKTIT

OBJEKTI : “STUDIM PROJEKTIM “STUDIM PROJEKTIM “STUDIM PROJEKTIM NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE TË QYTETIT KLOS” ” ”

VEND NDODHJA: QYTETI KLOS, BASHKIA KLOS.

QËLLIMI: PËRMIRËSIM I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KUN (“STUDIM PROJEKTIM “STUDIM PROJEKTIM NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE TË QYTETIT KLOS” ”)”, BASHKIA KLOS.

Janar 2024

Përmbajtje

Hyrje

- 1.1 Informacion i përgjithshëm
- 1.2 Përshkrimi i gjëndjes aktuale
- 1.3 Qëllimi i Investimit
 - 1.3.1 Qëllimi i shërbimit
 - 1.3.2 Rezultatet e pritshme
 - 1.3.3 Produktet e shërbimit
- 1.4 Zona e shërbimit
- 1.5 Objektivi i shërbimit të konsulencës

Shërbimi i Konsulencës lidhur me realizimin e Studim – Projektimit

- 2.1 Klasifikimi i objektit sipas grupit tarifor
- 2.2 Kriteret e projektimit
- 2.3 Detyrat e përgjegjësitë e konsulentit
- 2.4 Detyrat e detajuara sipas fazave
- 2.5 Shërbimet e rilevimit topografik
- 2.6 Shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis
- 2.7 stafi i konsulentit
- 2.8 Personeli

Kërkesat/Organizimi i shërbimit

- 3.1 Grafiku i realizimit të produktit
- 3.2 Mënyra e pagesës

1. HYRJE

1.1 Informacion i përgjithshëm

Qyteti i Klosit

Bashkia Klos ndodhet në zonën Verilindore të Shqipërisë dhe është pjesë e Qarkut Dibër, së bashku me 3 bashki të tjera: Dibër, Mat dhe Bulqizë. Ajo kufizohet në Jugperëndim me Bashkinë e Tiranës, në Veriperëndim me Bashkinë e Matit, në Lindje me Bashkinë e Bulqizës dhe në Verilindje me Bashkinë e Dibrës.

Klosi është një qytet në [Shqipëri](#), qendër i [Bashkisë Klos](#). Pranë qytetit të Klosit kalon lumi i Matit. Klosi ndodhet afer [Burrelit](#).

Bashkia Klos numëron një popullsi prej 20,281 banorësh.

Qyteti Klos numëron një popullsi prej 2,200 banorësh, dhe 520 familje.

Qyteti ka gjithsej 13 pallate të viteve para 90 dhe dy pallate të reja të ndërtuara rreth viteve 2019-2022. Pjesa tjetër e qytetit është me banesa private (individuale).

Zona Gjeografike: Klosi kufizohet në veri me bashkinë e Matit, në perëndim me bashkinë e Krujës, në jug-perëndim me bashkinë Tiranë, në jug-lindje me bashkinë Bulqizë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Klosit. Një pjesë e mirë e sipërfaqes së kësaj bashkie është zonë fushore që përbëhet nga lugina e Matit me kullota që variojnë nga 240 metra në 600 metra mbi nivelin e detit. Klosi është dhe mbetet një nyje që lidh Dibrën me Tiranën. Lëvizjet demografike të popullsisë drejt zonave urbane, karakteristike për rajonin e Dibrës, vihen re dhe në Klos

Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutorëve, blegtoria dhe shërbimet. Klosi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë mjekësore.

Qyteti i Klosit ka pike grumbullimi për mbeturinat dhe sistem të shkarkimit të ujërave të zeza, që bëhet në lumin Mat, jashtë standarteve teknologjike dhe mjedisore.

1.2 Përshkrim i gjëndjes aktuale

Qyteti i Klosit, ka një rrjet të kanalizimeve të ujrave të ndotura, tejet të amortizuar, në të cilin nuk janë bërë ndërhyrje në 25 vitet e fundit, përveç një segmenti në rrugën nacionale, nga dalja e Klosit në drejtim të Burrelit.

Aktualisht ujrat e ndotura, janë problem, pasi edhe derdhen në shtratin e lumit Mat, nuk kanë një Impjant të Pastrimit të tyre.

1.3 Qëllimi i investimit

Qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i dukshëm i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në qytetin e Klos. Kjo do të kontribuojë në mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës.

Investimi synon sigurimin e largimit dhe trajtimit të shëndoshë higjenikisht dhe mjedisor të ujërave të ndotura për zonën e përzgjedhur në zonën e studimit.

1.3.1 Qëllimi i shërbimit

Qëllimi i këtij shërbimi është kryerja e " **Studim Projektim Ndertimi i sistemit të kanalizimeve të qytetit Klos.**" me të gjithë komponentet përbërës të këtij sistemi duke përfshirë lidhjet familjare për zonën e përzgjedhur, kolektorin kryesor transportues të ujërave të ndotura, pusetat e kolektorëve.

1.3.2 Rezultatet e pritëshme

- ✓ Mbulimi i plotë me rrjet kanalizimesh për të gjithë zonën e studimit duke plotësuar nevojat higjenike dhe mjedisore të zones së studimit dhe lokaliteteve me rëndësi turistike.
- ✓ Rikonstruksioni dhe ndërtim i rrjetit të kanalizimeve në gjendje të amortizuar, kolektorët kryesorë përfshirë pusetat në të gjithë zonën e studimit.
- ✓ Treguesit për matjen e suksesit të programit është lidhja 100% e popullatës që jeton në zonën e shërbimit (Rezultati i drejtpërdrejtë) dhe standardet e vazhdueshme (24h/d) indirekt/afatgjatë.
- ✓ Masat përfshijnë rehabilitimin/ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve.

1.3.3 Produktet e shërbimit

1. Projekti paraprak, duke përfshirë projektimin hidraulik dhe projektimin e procesit për impiantin e trajtimit, për të gjithë komponentët kryesorë që do të zbatohen sipas projektit të propozuar.
2. Llogaritja e kostos së investimit për të gjithë komponentët e propozuar (rrjeti i kanalizimeve), duke përfshirë kostot fizike dhe kostot e pa parashikuara.
3. Vlerësimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes deri në vitin 2050.
4. Llogaritja e kostos kryesore dinamike (kostot e totale dhe kostot e O&M) deri në vitin 2050 duke marrë parasysh sistemin ekzistues të kanalizimeve dhe masat e sugjeruara të investimit.
5. Përpunimi i Projektit të Detajuar.
6. Përgatitja e vizatimeve të detajuara të punimeve civile në seksione dhe shkallë të ndryshme (1:50 dhe/ose 1:25) dhe plane të detajuara për pajisje dhe rakorderi sipas nevojës.
7. Përgatitja e planeve të detajuara të përforcimeve për punimet civile në shkallë (1:50 dhe/ose 1:25) sipas nevojës.
8. Specifikimi i të gjitha pajisjeve dhe materialit të nevojshëm për masat e ndërtimit, makinerive, pajisjeve dhe veglave për aktivitetet e Operim dhe Mirembajtje (p.sh. autoboot per pastrimin e kanalizimeve), si dhe pjesët rezervë që mund te nevojiten.
9. Përgatitja e Preventivit.
10. Përgatitja e të gjitha dokumenteve të nevojshme për të mundësuar marrjen e miratimeve, lejeve dhe licencave të nevojshme.

1.4 Zona e shërbimit

Zona e studimit do të jetë qyteti i Klosit. Ky studim synon, zgjerim të sistemit të kanalizimeve aktual, zgjerimin e zonën e shërbimit dhe për të rehabilituar sistemet egzistuese, në zgjerimin e sistemit të largimit të ujërave të ndotura, për të rritur vazhdimësinë e shërbimit sipas zonave.



Qyteti ka rreth 2,200 banorë, me një Sipërfaqe rreth 114ha.



1.5 Objektivi i shërbimit të konsulencës

Objekti: "**Studim Projektim Ndertimi i sistemit të kanalizimeve të qytetit Klos.**" ka për objektiv të realizojë fazat e projektimit nga II deri të VI sipas tabelës 9 të nenin 36 të VKM, Nr. 354, dt 11.05.2016 "***Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim***" mbi fazat e projektimit të veprave inxhinierike, duke përfshirë:

- Projekt-idenë paraprake
- Projekt-idenë përfundimtare
- Projektin për miratimin e lejes së ndërtimit
- Projektet e zbatimit
- Preventivin përfundimtar

Për më tepër, Konsulenti do të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha palët e tjera të përfshira në kryerjen e këtij studimi. Konsulenti gjatë ekzekutimit do të përshkruajë detyrat dhe shërbimet e tij në mënyrë të hollësishme. Përgjegjësia e konsulentit është që të verifikojë në mënyrë kritike fushën e shërbimeve të përcaktuara apo të shtuara, të reduktojë ose të ndryshojë çdo gjë që e gjykon të nevojshme sipas gjykimit të tij profesional gjatë përgatitjes së këtij propozimi. Kuptohet që Konsulenti do të kryejë të gjitha detyrat apo punët sipas nevojës për të përmbushur objektivat e këtij studimi.

2. SHËRBIMI I KONSULENCËS LIDHUR ME REALIZIMIN E STUDIMIT – PROJEKTIMIT

2.1 Klasifikimi i objektit sipas grupit tarifor IV

2.2 Kriteret e projektimit

2.2.1 Kriteret e projektimit të bazohen në KTP e projektimit të ujësjellës kanalizime në fuqi si, eurocodeve ATV-M-210 dhe jo vetëm.

2.2.2 Llogaritja e sasisë së ujit të ndotur të bazohet në njësinë litër/banor në ditë, shtret/në ditë për zonat turistike referuar turistëve ditorë dhe permanent

2.2.3 Projektimi të realizohet për një horizont planifikimi 25 vjeçar dhe duke marrë parasysh faktorët e rritjes sezonale dhe orare;

2.3 Detyrat e përgjegjësitë e konsulentit

Në realizimin e objektivave për: "**Studim Projektim Ndertimi i sistemit të kanalizimeve të qytetit Klos**" projektuesi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet të përgatisë sipas nenit 37, të VKM.354, dt 11.05.2016 "Shërbimet për planifikimin e objekteve ndërtimore inxhinierike dhe të komunikacionit" sipas fazave të mëposhtme:

- FAZA II- Projekt-idenë paraprake
- FAZA III- Projekt-ideja përfundimtare
- FAZA IV - Projektet për miratimin e lejes së ndërtimit
- FAZA V- Projektet e zbatimit
- FAZA VI - Preventivat përfundimtar

2.4 Detyrat e detajuara sipas fazave

FAZA II- Projekt-idenë paraprake (përgatitja e projektit dhe planifikimit)

Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhje të detyrës së planifikimit

- i. Shërbime bazë
 - a) Akordimi i qëllimeve të përfytyruara me kushtet anësore, të cilat jepen veçanërisht nga rregullimi i territorit, planifikimi i ndërtimit, planifikimi i detajuar vendor si dhe nga planifikimet e pergjithshme vendore dhe kombëtare.
 - b) Studimi i 3 opsioneve të zgjidhjes me influencat mbi kompozimin ndërtimor dhe konstruktiv, përshtatshmërinë, rentabilitetin duke respektuar pajtueshmërinë me mjedisin, sigurimi dhe vlerësimi i hartave zyrtare.
 - c) Përpunimi i një koncepti planifikimi, përfshirë studimin zgjidhjeve të mundshme alternative me kërkesa të njejta me paraqitje vizimore dhe vlerësim duke përpunuar kontribute të pjesëmarrëse të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
 - d) Sqarimi dhe shpjegimi i lidhjeve themelore specifike të specialistit, proçese dhe kushte.
 - e) Bisedime paraprake me autoritete dhe pjesëmarrës të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, për aftësinë për miratim, në rast se duhet për pagesë (sponsorizim) dhe pjesëmarrje në shpenzime.
 - f) Bashkëveprim në shpjegimin e konceptit të planifikimit kundrejt qytetarëve dhe organeve politike.
 - g) Përpunimi i konceptit të planifikimit sipas vërejtjeve dhe propozimeve.
 - h) Përgatitja e dokumentave si ekstrakte nga projektideja paraprake për përdorim për një proçedurë të rregullimit të territorit.
 - i) Vlerësimi i shpenzimeve kapitale dhe operim-mirëmbajtje (preventivi).

j) Përmbledhja e të gjitha rezultateve të planifikimit paraprak.

Rezultatet e pritura të këtij aktiviteti do të jenë:

1. Modele hidraulike për analiza të skenarëve të ndryshëm.
2. Raporti mbi Programin e Rehabilitimit / Optimizimit i cili detajon modelimin e sistemit, analizën e sistemit dhe përzgjedhjen e alternativave për të gjithë zonën e studimit me rekomandimet për UK që duhet të ndërmarrë.
3. Hartime të hollësishme të projekteve të përforcimit të rrjetit të zonimit dhe punëve të tjera të nevojshme.

FAZA III-Projekt-ideja përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së projektimit/termave të referencës.

- i. Shërbime bazë
 - a) Përpunimi i konceptit të planifikimit (përpunimi hap pas hapi i një zgjidhjeje vizatimore) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në projektidenë e plotë.
 - b) Raport shpjegues.
 - c) Llogaritje specifike të fushës, përjashtoj llogaritjet e strukturës mbajtëse.
 - d) Paraqitje vizatimore e të gjithë projektidesë.
 - e) Plani i financimit, plani i kohëve të ndërtimit dhe i shpenzimeve. Llogaritja dhe argumentimi i shpenzimeve që mund të sigurohen me ndihmë (subvencionim) si dhe përgatitja e kërkesave për financim; bashkëpunim gjatë shpjegimit të projekt-idesë paraprake ndaj qytetarëve dhe organeve publike; Përpunimi i projektidesë sipas vërejtjeve dhe propozimeve.
 - f) Bisedime me autoritete dhe pjesëmarrës të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, për aftësinë për miratim.
 - g) Llogaritja e shpenzimeve.
 - h) Kontrolli i shpenzimeve duke krahasuar llogaritjen e shpenzimeve me vlerësimin e shpenzimeve
 - i) Përmbledhja e të gjitha dokumenteve të projektidesë.
 - j) Raport dhe analizë mbi efikasitetin e energjisë elektrike për sistemin hidraulik të miratuar.
- ii. Shërbimet e veçanta
 - a) Sigurimi i ekstrakteve nga libri themeltar, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe dokumente të tjera zyrtare.
 - b) Vazhdimi i studimeve dobi-shpenzime.
 - c) Bashkëveprim gjatë marrëveshjeve administrative.
 - d) Studimet e fizibilitetit social dhe teknik.

Rezultatet e pritura të këtij aktiviteti do të jenë:

1. Modeli hidraulik dhe analiza të skenarit të zgjedhur.

2. Raport dhe analizë mbi efikasitetin e energjisë elektrike për sistemin hidraulik të miratuar.
3. Raporti mbi Programin e Rehabilitimit / Optimizimit i cili detajon modelimin e sistemit, analizën e sistemit alternativën e përzgjedhur për të gjithë zonën e studimit.
4. Hartimi i planit menaxhimi për zbatimin e planit të veprimit të optimizuar, i cili detajon përgjegjësitë e palëve të interesit, planin e planifikimit dhe buxhetin, planin e prokurimit dhe të burimeve njerëzore dhe planin e menaxhimit të rrezikut.
5. Raport mbi Planin e Veprimit të Optimizuar. Përgatitja e listës projekteve të detajuara duke i prioritetizuar investimet.
6. Bazuar në Planin e Veprimit të Optimizuar të hartojë të gjitha ndërhyrjet dhe komponentët e tij të përfshira në Planin e Veprimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Përcaktojë alternativat më të realizueshme për zbatimin e Planit të Veprimit me të veçanta konsideratë për kontraktimin e bazuar në performancë.
8. Bazuar në analizat alternative për zbatimin e Planit të Veprimit, përpunohen dokumentet e tenderit për opsionet.

FAZA IV-Projektet për miratimin e lejes së ndërtimit

Përpunimi dhe dorëzimi i dokumenteve për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

i. Shërbimet bazë

- a) Përpunimi i dokumenteve e nevojshme për procedurat publike e ligjore përfshirë kërkesat për raste përjashtimore dhe lirime (nga detyrime), përmbledhja e dokumentacionit të veprës ndërtimore dhe përdorimi i kontributeve të pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;
- b) Dorëzimi i dokumenteve;
- c) Plani për blerjen/shpronësimin e truallit dhe dokumentet për blerjen/shpronësimin e truallit;
- d) Plotësimi dhe përshtatja e dokumenteve të planifikimit, përshtatje dhe llogaritje duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;
- e) Bashkëpunim gjatë shpjegimeve ndaj qytetarëve në degjese publike dhe jo vetem;
- f) Bashkëveprim në procedurën e miratimit të planit përfshirë pjesëmarrjen në takime shqyrtimi si dhe bashkëveprim në hartimin e qëndrimit ndaj vërejtjeve dhe propozimeve;

ii. Shërbimet e veçanta

- a) Bashkëveprim në sigurimin e aprovimit të të prekurve.
- b) Hartimi i dokumenteve për themelimin e bashkimeve.

FAZA V- Projektet e zbatimit

Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

i. Shërbimet bazë

- a) Përpunimi i rezultateve të fazave të punimeve 3 dhe 4 (përgatitja hap pas hapi e zgjidhjes dhe e paraqitjes së saj) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të

- fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në zgjidhjen e aftë për zbatim;
- b) Paraqitje vizatimore dhe llogaritëse e objektit me të gjitha të dhënat e veçanta të nevojshme për zbatimin, përfshirë vizatime të detajuara në shkallët e kërkuara;
 - c) Përpunimi i bazave për të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, dhe integrimi i kontributeve të tyre deri në zgjidhjen e aftë për zbatim;
 - d) Vazhdimi i planifikimit të zbatimit gjatë ndërtimit të objektit.

ii. Shërbimet e veçanta

- a) Hartimi grafikut të punimeve dhe i planeve të rrjetit të infrastrukturës.

Rezultatet e pritura të këtij aktiviteti do të jenë:

- Hartimi i projekteve të zbatimit sipas prioriteteve të përcaktuara dhe punëve të tjera të nevojshme.

FAZA VI-Preventivat përfundimtar

Llogaritja e sasive, përgatitja e analizave të çmimeve dhe hartimi i dokumentave të tenderit.

i. Shërbimet bazë:

- a) Llogaritja e sasive dhe renditja e pozicioneve të veçanta duke përfshirë kontributin e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;
- b) Hartimi i dokumenteve të dhënies, në mënyrë të veçantë i përshkrimeve të punëve me listën e punëve si dhe të kushteve të veçanta kontraktuale;
- c) Akordimi dhe koordinimi i dokumenteve të dhënies me pjesëmarrësit e tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;
- d) Përcaktimi i fazave kryesore të zbatimit;
- e) Çmimet e preventivit të hartohet sipas VKM në fuqi.

2.5 Shërbimet e rilevimit topografik

Shërbimet e rilevimit topografik bazohen në nenin 63 sipas VKM, Nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" dhe përfshijnë:

Këto shërbime duhen cilësuar si shërbime me kërkesa mesatare për topografinë sipas grupit III tarifor të nenit 67 të V.K.M Nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Shërbimet për rilevimin topografik në fazën e projektimit janë përcaktuar sipas nenit 66 ku konsulenti do të përgatisë punën për studimin e nevojshëm topografik në zonën e projektit sipas fazave të mëposhtme:

Faza I: Analizës e detyrës së projektimit, termave të referencës, dhe përcaktimi bazës së projektit referuar shërbimit topografik.

i. Shërbimet bazë

- Gjetja dhe marrja e informacionit dhe dokumentacionit në vendndodhjen ku është planifikuar objekti
- Gjetja e dokumentacionit të rilevimit. Inspektimi në vend.
- Vendosja e qëllimit të projektit e lidhur relativisht me kërkesat e saktësisë dhe shkallën e vështirësisë

ii. Shërbime të veçanta

Marrja e lejeve me shkrim për të hyrë në truallin për ndërtim, leje transporti në ujë dhe leje për masat e sigurisë ndaj trafikut që kërkon autorizim.

Faza II: Grupimi i pikave të palëvizshme gjeodezike

i. Shërbime bazë

- Identifikimi dhe shënimi i pikave për pozicionim dhe rilevim.
- Hartimi i përshkrimeve për pikat e palëvizshme dhe shoqëruar me skemat përkatëse.
- Kryerja e matjeve për të përcaktuar pikat fikse dhe ato të kontrollit.
- Analizimi i matjeve dhe hartimi i rrjetit mbështetës gjeodezik dhe atë të rilevimit.

ii. Shërbime të veçanta

- Analiza e rrjetit dhe grafikut të punimeve të rilevimit për rrjete tokësore shumë ekzakte.
- Shënimi i piketave për kërkesa të veçanta.
- Instalimi i pikave fikse dhe stacionet.

Faza III: Planet e pozicionimit dhe të rilevimit

i. Shërbime bazë

- Studimet topografike/morfologjike (tokësore/ajrore) duke përfshirë regjistrimet e pikave kufizuese.
- Analiza e matjeve/fotografive ajrore.
- Hartimi i planeve që paraqesin situatën e objektit duke përfshirë zonën e mbuluar nga projekti dhe të dhënat kadastrale.
- Paraqitja e rilevimeve në format të pikëzuar, matrica ose në formë vizash konturuese.
- Hartimi i një model terreni të dixhitalizuar.
- Prezantim grafik i kanaleve, rrjetit elektrik, kabllot dhe strukturat nëntokësore sipas dokumentacionit ekzistues.
- Të gjitha matjet të jenë në format dixhitale.

ii. Shërbime të veçanta

- Masa të shumta për sigurinë nga trafiku që kërkojnë autorizim (nëse është e nevojshme).
- Përfshirja e të dhënave të pronësisë.
- Paraqitja e të dhëna në shkallë të ndryshme.
- Përgatitja e planeve të pozicionit në lidhje me kërkesat ligjore për procedurat e pranimit zyrtar.

Faza IV: Vizatime të piketave

Llogaritja e matjeve gjeometrike bazuar në projekt dhe përpilimi i dokumentacionit dhe piketimit

i. Shërbime bazë

- Piketimi për projektin.
- Përcaktimi dhe transferimi i vijës referenciale për objekte lineare në kantier.

- Përcaktimi dhe transferimi i gjeometrisë së projektit në kantier për procedurat e orientimit dhe të vendosjes së kondicioneve urbane.

Faza V: Projektet e zbatimit: Piketat për qëllime planifikimi

i. Shërbime bazë

- Transferimi në terren i vijës referenciale për objektet lineare (p.sh. kufiri i ndërtimit).
- Transferimi i gjurmës së projektit në terren për kontrollin e aktit të piketimit të objektit nga organet kompetente.

Faza VI: Seksionet gjellogjike për rilevimet topografike

Identifikimi dhe paraqitja e profileve gjatësore dhe tërthore nga matjet tokësore dhe fotogrametrike.

2.6 Shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis

Shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis do të përcaktohen sipas nenit 74 si shërbimet bazë, që i takojnë studimeve të ndikimit në mjedis, për të vlerësuar gjendjen ekzistuese si pjesë e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe sipas fazave, Nenit 76, VKM, Nr. 354, datë 11.05.2016 sipas Grupit III tarifor: Studime të ndikimit në mjedis, me një shkallë vështirësie të lartë, specifikisht për një zonë në studim dhe në baze të Nenit 75, VKM, Nr. 354, datë 11.05.2016 do të zbatohet këto shërbime si më poshtë:

Shërbimet për studimet e ndikimit në mjedis:

Faza IV: Aplikimi për deklaratë Mjedisore

Në përfundim të dëgjësës vlerësohen komentet e publikut dhe hartohet Raporti i Thelluar i VNM-së, sipas kriterëve të legjislacionit përkatës në fuqi.

2.7 STAFI I KONSULENTIT

Stafi i propozuar për këtë studim duhet të jetë si më poshtë:

Projektues hidroteknike/ndërtimi i cili do jetë Lideri i ekipit ekspert në projektimin e veprave hidraulike, ndërtimit të Ujërave të Ndotura(KUZ).

Detyra do të udhëhiqet nga Inxhinier Hidroteknik/Ndërtimi i cili do të jetë lideri dhe përgjegjës për mbikëqyrjen teknike të ekipit të ekspertëve, për sigurimin e progresit të planit, për koordinim me SHR UK Dibër dhe për të raportuar apo theksuar çështjet kritike në zbatimin e projektit.

Projektues hidroteknike/ndërtimi specialist në projektimin e veprave hidraulike, ndërtimit dhe operimit:

- ✓ Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi
- ✓ Ujësjellës kanalizime urbane – rurale
- ✓ Vepra të trajtimit të ujit. Kjo kategori jepet vetëm për personat juridikë (shoqëri/studio)

Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, Vepra të trajtimit të ujit, marrje uji, shkarkimi– shkarkues të ujërave të tepërta, vepra ë marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse
Gjithashtu ekspertë të tjerë projektues mbështetës në grupin e planifikimit dhe projektimit të Ujësjellës-Kanalizime dhe detaje të ndërtimit, dhe të ndërtimit në kushte të ngjashme me ato në terren në zonën e projektit të këtij shërbimi.

Projektues konstruktor:

Ekspert në projektimin të strukturave beton-arme të qëndrueshme me/pa prani të ujit.

Projektues gjeodet:

Expert me njohuri të metodave moderne të studimit dhe prodhimin e hartës dixhitale në:

- Bazamente gjeodezike
- Rivelime në të gjitha shkallët
- Projektim fotogrametrik
- Hartografike/Topografike

Projektues elektrik/mekanik

Ekspert me njohuri në projektimin e ndërtimeve, mirëmbajtjeve ose ristrukturimeve me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojshëm për funksionim, sigurim dhe asistencë

Projektues gjeologjor inxhinierik – hidrogjeologjik

Ekspert me njohuri të projektimit e shpimeve për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik dhe Shpimet për ujë dhe puse.

- ✓ Studim/Vlerësim gjeologjor-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- ✓ Studime e projektme hidrogjeologjike për veprat e marrjes së ujit

Inxhinier mjedisi

Ekspert në vlerësimin mjedisor me licensën përkatëse në fushën ujësjellës- kanalizime dhe trajtim ujërash.

Stafi mbështetës

Në varësi të ekspertizës aktuale të kontraktuar për të bërë punë mund të ketë disa ndryshime të vogla për të mbuluar të gjitha kërkesat. Një numër i eksperteve do të mbahen në rezervë për çështje të paparashikuara dhe që nuk janë në gjendje të mbuloohen nga ekipi.

Nëse nuk shprehet ndryshe, ekspertët do të kenë profilet e mëposhtme:

- **Inxhinier Hidroteknik** me ekspertë të ngjashme, mundësisht me përvojë të mëparshme në projekte të ujësjellësave të jashtëm
- **Inxhinier Gjeodet** me ekspertë të ngjashme, mundësisht me përvojë të mëparshme në projekte të ujësjellësave të jashtëm
- **Inxhinier Ndërtimi** me ekspertë të ngjashme, mundësisht me përvojë të mëparshme në të ujësjellësave të jashtëm

Arsimim të lartë në një disiplinë që është e ngjashme për detyrën e tyre në këtë shërbim

Të përdor perfekt programet e MS Office dhe programeve specifike sipas profileve të punës

❖ **Detyra e stafit**

Detyrat specifike:

Inxhinier hidroteknik /ndërtimi (Udhëheqës i ekipit)

Detyrat specifike:

- 1- Koordinimi i përgjithshëm i mbështetjes dhe ekspertizës në kuadër të projektit.
- 2- Ndërlidhje me sektorin e mjedisit, ekspert kryesor dhe koordinimin e burimeve nga zyra e projektit.
- 3- Shqyrtimi dhe miratimi i punës së ekspertëve të ekipit dhe integrimin e punës së përgjithshme të projektimit.
- 4- Ofrimi i mbështetjes me ekspertë në lidhje me shërbimin në aspektet teknike, ligjore, operacionale, si dhe çështje të specializuara, të tilla si sistemet teknike etj.
- 5- Specifikimi i kërkesave hidroteknike për të gjitha komponentet e ujit.
- 6- Përgatitja e preventivit dhe analizat e kostos.
- 7- Hartimin e relacionit teknik.
- 8- Hartimi e specifikimeve teknike.

Profili i Ekspertit:

- ✓ Diplomuar për Inxhinieri hidroteknik/ndërtimi.
- ✓ Përvojë e ngjashme në projektimin e zbatimit të ujësjellës-kanalizime (15 vite).
- ✓ Njohje e projektimit të stacionit të pompimit nga të dy aspektet strukturore dhe elektro-mekanike.
- ✓ Njohuri përkatëse të standarteve shqipëtare dhe të BE-së dhe kushtet teknike të projektimit në lidhje me projektimin e sistemit të Ujësjellsave të jashtëm.

Inxhinier strukturist

Detyrat specifike:

- ✓ Projektimi i strukturave beton-arme me/pa prani të ujit (10 vite).
- ✓ Vlerësimi i ngarkesave në tubacionet, puseta apo dhoma kontrolli.
- ✓ Ndhurma me negociatat në lidhje me kalimet e rrugëve kryesore dhe hekurudhat nëse do nevojitet.

Profili i Ekspertit:

- ✓ Diplomuar në inxhinieri ndërtimi/ strukturist
- ✓ Të posedoj Liçensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvoja të ngjashme me kërkesat për projektimin e betoneve mix për mbrojtje konkrete për t'i bërë ballë kushteve të mundshme agresive

Eksperti Gjeodet

Detyrat specifike:

Hartimi i planeve profileve terthorë dhe gjatësore topografike me kuota dhe hartave GIS Njohja me planet topografike ekzistuese për rrejetet e ujësjellësave në zonat e zhvilluara

Profili i Ekspertit:

- ✓ Diplomuar në Inxhinier profili gjeodet / topograf/markshnaider
- ✓ Të posedoj Liçensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvojë ngjashme të punëve topografike
- ✓ Përvoja praktike e software për krijimin e hartave Gis

Inxhinier elektrik/mekanik

Detyrat specifike:

- ✓ Projektimi për impiantet elektrike, mekanike, stacionet e pompimit, makinerive, paisjeve por jo vetëm të kufizuar në to
- ✓ Specifikimi i kërkesave elektro /mekanike për impiantet elektrike, mekanike stacionet e pompimit, makinerive, paisjeve por jo vetëm të kufizuar në to.
- ✓ Përgatitja e preventivit dhe analizat e kostos për pajisje elektro-mekanike
- ✓ Hartimin e relacionit teknik për elektro-mekanike
- ✓ Hartimi e specifikimeve teknike elektro-mekanike

Profili i Ekspertit:

- ✓ Diplomuar në Inxhinieri Elektrike
- ✓ Të posedoj Liçensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvojë ngjashme të punëve në inxhinieri elektro-mekanike në sektorin e ujit
- ✓ Përvojë praktike në projektimin e stacioneve të pompimit

Inxhinier gjeologo inxhinierik –hidrogjeologjik

Detyrat specifike:

- ✓ Të këshillojë mbi çështjet e tabanit që ndikojnë në projektimin dhe integritetin e Ujësjellësave të jashtëm dhe strukturave të lidhura me to
- ✓ Të këshillojë mbi çështjet gjeoteknike lidhje me gërmimet e thella, kalimet e ndryshme.
- ✓ Hartimin e relacionit gjeologjik
- ✓ Hartimin preventivit dhe analizat e çmimeve

Inxhinier mjedisi

Expert në vlerësimin mjedisor me liçensën përkatëse në fushën ujësjellës-kanalizime dhe trajtim ujërash.

Detyrat specifike:

- Raportin teknik të projektit të propozuar
- Raportin paraprak të VNM-së,
- Aplikimi për deklaratë Mjedisore

Profili i Ekspert:

- ✓ Diplomuar në Mjedis/Ndërtim
- ✓ Të posedoj Liçensë me kategorinë përkatëse
- ✓ Përvojë në projektet për vlerësimin mjedisor

3. KËRKESAT /ORGANIZIMI SHËRBIMIT

3.1 Grafiku i realizimit të produktit

Shërbimi do të ketë një kohëzgjatje të përgjithshme prej **4 muaj** për prezantimin e Produktit Final të projektimit, duke përfshirë të gjitha vizatimet e detajuara të projektimit, dokumentat dhe raportet, specifikimet etj.

Të gjitha raportet dhe dokumentet e përgatitura në bazë të këtij projekti do të jetë në gjuhën shqipe dhe një kopjë në gjuhën angleze.

Në përgjithësi, raportet e rezultateve do të shpërndahen së pari në draft -projekt, duke u diskutuar dhe duke u pajtuar me grupet e interesit, para finalizimit bazë të komenteve të marra.

Produket përfundimtare

- ✓ Projekt-idenë paraprake, 1 muaj (Skema hidraulike paraprake, raportet mbi përshkrimin e shkurtër të skemës ekzistuese apo asaj propozuese, kriteret e projektimit, stacionet e pompimit, kolektorët kryesor, rrjeti sekondar dhe tercial si dhe impiantin e trajtimit të ujerave të ndotura, vlerësimi i kostos në njësi, kostot e investimit në total dhe kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, dokumenta të mbledhura për planifikimin dhe preventivi paraprak)
- ✓ Projekt ideja përfundimtare, 1 muaj (Skema hidraulike përfundimtare, llogaritjet hidraulike në formë hard copy dhe elektronikisht, raportet mbi përshkrimin e skemës përfundimtare, kriteret e projektimit, problemet me pronësinë, vlerësimi i kostos në njësi, kostot e investimit në total dhe kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, grafiku i punimeve dhe dokumentat e mbledhura për planifikimin,
- ✓ Projektet për miratimin e lejës së ndërtimit, 10 ditë
- ✓ Projektet e zbatimit finale, 1 muaj (përfshin të gjitha vizatimet përfundimtare, relacionet teknike, specifikimet, analizën tekniko-ekonomike raportet të përmendura me lart sipas detyrave të përcaktuara në këto terma) + VNM.
- ✓ Preventivi përfundimtar dhe analizat e çmimeve përfundimtare, 20 ditë

Produkti final do të dorëzohet në 5 kopje si dhe 1 kopje në formë elektronike (llogaritjet hidraulike) dhe autocad.

3.2 Mënyra e pagesës

Pagesa do të kryhet sipas nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr 354, dt 11.05.2016" "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" ku:

3.2.1 Pagesa duhet të shlyhet, nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, kur shërbimi është kryer konform kontratës dhe është paraqitur tek porositësi një faturë e kontrollueshme.

Në koston e llogartishme përfshihen kostot e planifikim-projektimit për 6 fazat:

Faza ii- Projekt-idenë paraprake 15%

Faza iii- Projekt-ideja përfundimtare 25%

Faza iv - Projektet për miratimin e lejës së ndërtimit 2%

Faza v- Projektet e zbatimit 18%

Faza vi- Preventivin përfundimtar 10%

Këstet mund të paguhet në afatet e përcaktuara në kontratë ose në distanca kohore logjike për shërbime të kryera dhe të vërtetueshme.

Për modalitete të tjera të pagesës duhet të bihet dakort me shkrim.

Kërkesat për raportimet dhe dorëzimet e shërbimeve.

1. Kërkesat për raportimet

Raportimi i detajuar dhe përgatitja e dorëzimit në kohë të shërbimeve është i rëndësishëm për projektin. Në vijim janë renditur raportet/shërbimet që duhet të dorëzohen periodikisht, afatet e dorëzimit dhe një përshkrim i përmbajtjes së tyre. Këto janë dokumenta dinamike, subjekt ndryshimesh, për të përmirësuar ato apo për të reflektuar nevojat e Autoritetit Kontraktues.

2. Kërkesat për dorëzimin e dokumentacionit dhe shërbimeve

- Numri i kopjeve të printuara dhe dorëzimi i raporteve dhe shërbimeve tek Autoriteti Kontraktues do të kryhet sipas tabelës së mëposhtme. Çdo material do të dorëzohet së bashku me një kopje elektronike në CD/DVD, sipas nevojës.
- Dorëzimi i projektit të zbatimit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Projekti i zbatimit duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur në origjinal nga Kontraktori.
- Bashkëngjitur me projektin duhet të sillen edhe miratimet apo opsionet e pushtetit lokal ose të institucioneve të tjera, që kanë bashkëpunuar dhe që janë pjesëmarrës dhe aktorë në këtë projekt.
- Projekti i printuar do të dorëzohet në 5(pesë) kopje të firmosura e vulosura në origjinal dhe në formatet e miratuar nga Autoriteti Kontraktor ne varesi te llojit te projektit (A3 ose nje format tjetër i pershtatshëm).
- Raportet do të dorëzohen te printuara ne 5 (pesë) kopje të firmosura e vulosura në origjinal dhe në formatet e kërkuara A4.
- Projekti i Zbatimit do të dorëzohet gjithashtu në dy kopje elektronike (në 2 CD/DVD në format soft copy Cad,Exel,Word etj, dhe 1 cd në format PDF me vule elektronike)

Raportimi dhe dorëzimi final

Ky projekt duhet të dërgohet për oponencë sipas udhëzimeve përkatëse.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari.

Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë projektuesit.